

HAMIT KABA

**PËRPPJEKJE PËR AFRIM: MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË
ME SHBA DHE ANGLINË NË VITET 70-80**

Shqipëria: larg Evropës dhe Amerikës, por afër Kinës

Politika e jashtme e Shqipërisë nga viti 1961 e deri në vitin 1978 ka qenë e orientuar tërësisht drejt Kinës, mbi bazën e afinitetit të ngushtë ideologjik. Shqipëria ka mbajtur qëndrim armiqësor ndaj Bashkimit Sovjetik e SHBA-së dhe ka qenë deri diku e izoluar edhe nga pjesa tjetër e botës. Ajo qëndronte jashtë të dy Blloqeve të mëdhenj, të Lindjes apo të Perëndimit, larg ‘ngatërresave’ shumëpalëshe evropiane e botërore, larg bashkëpunimit ballkanik e po kështu larg Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë [KSBE].

Marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me SHBA dhe Britaninë e Madhe nuk arritën të rivendoseshin në vitet 1945-1946 për arsye tashmë të njohura. Ato u rivendosën në vitin 1991, pas rënies së regjimit komunist dhe kapërcimit të pengesave të trashëguara. Gjatë 20 viteve të para të pasluftës, qeveritë shqiptare kishin ruajtur iniciativën dhe interesin për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA, ndërsa duke filluar nga gjysma e dytë e viteve 60-të e më pas iniciativa do t’u kalonte SHBA-ve.

Përmirësimi i marrëdhënieve shqiptaro-angleze nuk mund të arrihej pa zgjidhur problemet e shkaktuara nga incidenti i kanalit të Korfuzit, pa e dëmshpërblyer Anglinë sipas vendimit të Gjykatës së Hagës dhe pa i kthyer Shqipërisë arin e saj monetar, të bllokuar nga Komisioni Tripalësh.

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Federale Gjermane, sikurse edhe për vendet e tjera ish komuniste të Evropës u shtrua si problem për zgjidhje në fillim të viteve 70-të, pas zëvendësimit të doktrinës “Hallstein” me “Ostpolitik”-ën” e iniciuar nga kancelari gjerman, Willy Brandt* dhe hapave që u morën në përmirësimin e

* *Willy Brandt* ishte udhëheqësi i Partisë Socialdemokrate Gjermane (1964 -1987) dhe kancelar i Republikës Federale Gjermane në vitet 1969-1974. Ai i dha fund

marrëdhënieve Lindje-Perëndim. Por, Shqipëria, për shkak të politikës së ndjekur nga qeveria komuniste mbeti larg zhvillimeve evropiane e botërore. Ajo ishte i fundit vend në Evropë që vendosi marrëdhëniet diplomatike me RFGJ.

Pas një kohe të gjatë refuzimesh e hezitimesh qeveria amerikane në fund të viteve 60-të dhe në fillim të viteve 70-të, mori iniciativën për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Ky ndryshim nuk erdhi për shkak të zbutjes së regjimit komunist në Shqipëri, por ishte pjesë e vizionit të ri politik të SHBA, të iniciuar nga presidenti Nixon. Thelbin e kësaj politike, të njohur me termin “Realpolitika” e përbënte pranimi i realiteteve të caktuara në marrëdhëniet e SHBA me vendet komuniste të Evropës Lindore e Qendrore¹, pavarësisht nga natyra e tyre politike e ideologjike. Tendenca për ndryshime në politikën amerikane në trajtën e saj virtuale ishte shfaqur para ardhjes së Nixon-it në Shtëpinë e Bardhë në vitin 1969. Që në vitin 1964 ishin hedhur ide për të “ndërtuar ura” në marrëdhëniet me vendet komuniste të Evropës Lindore dhe jo vetëm me BS, me qëllim që të lehtësoheshin dhe mbështeteshin ndryshimet konstruktive në këto vende e të shkohej drejt ribashkimit të Evropës Lindore e Qendrore me Perëndimin. Ribashkimi nuk kuptonte një entitet politik, aleancë ushtarake apo forcë të tretë. Ai nënkuptonte lidhje më të afërta bilaterale, kontrollin e armëve dhe marrëdhënie shumëpalëshe². Nevojën e ndryshimeve të thella në politikën e jashtme të SHBA e kishte nënvizuar Nixon-i që në vitin 1967, nëpërmjet një artikulli të botuar në revistën “Foreign Affairs Magazine”.

Në korrik 1967, diplomatë amerikanë u propozuan për herë të parë në mënyrë të drejtpërdrejtë përfaqësuesve të misionit shqiptar pranë Kombeve të Bashkuara në New York, fillimin e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve diplomatike dhe zgjidhjen e disa

“Doktrinës Hollstein”, sipas së cilës RFGJ-ja nuk vendoste marrëdhënie diplomatike ose i ndërpriste ato me shtetet që njihnin RDGJ, duke e zëvendësuar atë me “Ostpolitika”. Me këtë të fundit ai i hapi rrugë procesit të ripajtimit të RFGJ me vendet e Evropës Lindore dhe njohjes prej saj të Republikës Demokratike Gjermane.

¹ Hamit Kaba, “Politika e SHBA ndaj Shqipërisë në vitet 70 dhe reflektimi i saj në NATO”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2008, f. 1.

² *The National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), RG 59, “Ndërtimi i urave me Europën Lindore”, përgatitur nga Këshilli i Planifikimit të Politikave, 31 korrik 1964, f. 2.

problemeve të tjera, por qeveria shqiptare nuk iu përgjigj iniciativës amerikane³.

Ideja për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë u diskutua sërish në Washington në prag të vizitës së presidentit Nixon në Rumani në vitin 1969⁴. Propozimet e qeverisë amerikane u bënë konkrete e të qarta në mënyrë të veçantë pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës në gusht 1968, vendosjes së kontakteve amerikano-kineze për normalizimin e marrëdhënieve, por edhe pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-kineze. Nevojën e përmirësimit të marrëdhënieve me Shqipërinë e përmendi edhe sekretari Amerikan i Shtetit Rogers në janar 1970, gjatë një interviste me kryeredaktorin e gazetës “Le Monde”⁵.

Ndër hapat e shënuara të qeverisë shqiptare në fillim të viteve 70-të ishte vendosja e marrëdhënieve diplomatike me vendet e Benelux-it, si me Belgjikën, Holandën e Luksemburgun, por edhe me Zvicrën e Austrinë, si dhe me vendet nordike: Suedinë, Norvegjinë e Danimarkën. Por ajo vazhdoi ta mbante derën të mbyllur ndaj çdo përmirësimi në marrëdhëniet me SHBA. Në verën e vitit 1971, Tirana kishte vendosur marrëdhënie diplomatike me shumicën e vendeve evropiane, me përjashtim të Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë Perëndimore⁶. Qeveria shqiptare, parimisht, nuk e përjashtonte opsionin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Britaninë e Madhe dhe me Republikën Federale Gjermane, por ajo vinte si kusht zgjidhjen e problemeve të trashëguara nga e kaluara, siç ishin problemet e arit monetar me Anglinë dhe kthimi i dëmshpërblimeve të Luftës së Dytë Botërore nga RFGJ.

Në raportin e vitit 1971 për politikën e jashtme të SHBA, sekretari i Shtetit Rogers, shfaqti gatishmërinë e qeverisë amerikane për të intensifikuar procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Shqipërinë.

³ Paskal Milo, “Shqipëria në vitet e tronditjeve të mëdha të sistemit (1960-1990)”, në *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2009, f. 314.

⁴ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), Viti (më tej: V.) 1969, Dosja (më tej: D.) 304, fl. 6, Telegram i Sokrat Plakës nga New York-u, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, më 10.09.1969.

⁵ *Po aty*, V. 1970, D. 48, fl. 49.

⁶ NARA, RG 59, “Shqipëria: Ndryshimet e politikës së jashtme”, përgatitur nga Stephen Peters, 4 janar 1972, f. 6. Në nëntor të vitit 1971 Shqipëria kishte marrëdhënie diplomatike në nivel ambasadorësh me mbi 50 vende (krahasuar me 35 në vitin 1966), ndonëse shkëmbimi aktual i ambasadorëve nuk i kalonte disa dhjetëra.

Pozicioni i ri i Departamentit të Shtetit ndaj Shqipërisë iu bë i njohur ambasadave amerikane kudo ku ndodheshin, por, rol të veçantë do të kishin ambasadat amerikane në Romë, Beograd e Athinë. Këto ambasada u ngarkuan të përcillnin mesazhin e qeverisë amerikane se ajo donte realisht të rivendoste marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë, duke siguruar [këtë të fundit] se “qëndrimi i SHBA ndaj Shqipërisë nuk është armiqësor, dhe ne mezi presim ditën kur udhëheqësit shqiptarë do ta shqyrtojnë me seriozitet përmirësimin e marrëdhënieve me SHBA”⁷. Koha e zgjedhur për t’i ofruar qeverisë shqiptare mundësinë e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike ishte e favorshme, sepse Shqipëria ishte tërhequr zyrtarisht nga Traktati i Varshavës dhe ekzistonte frika e ndonjë sulmi të mundshëm nga Bashkimi Sovjetik dhe aleatët e tij. Mendohej gjithashtu se, afrimi amerikano-kinez mund të ndikonte edhe në “shkrirjen e akujve” ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA. Dukej se pas daljes nga Traktati i Varshavës problemet e sigurisë në Shqipëri kishin fituar përparësi ndaj problemeve të tjera, përfshirë edhe ato ideologjike. Ndihma ushtarake e Kinës, me gjithë shkëmbimin intensiv të delegacioneve ushtarake ndërmjet të dy vendeve dhe deklaratave të forta të udhëheqjes së lartë kineze në mbrojtje të Shqipërisë, nuk përbënin ndonjë garanci për mbrojtjen e saj. Kina gjendej shumë larg Shqipërisë, dhe efektiviteti i ndihmës së saj ishte e diskutueshme, pavarësisht retorikës së Mao Ce Dunit. Gatishmëria e udhëheqjes kineze për të mbështetur Shqipërinë nga ndonjë sulm i armatosur ishte e pasigurt. Partia Komuniste e Kinës që në vitin 1963 e kishte refuzuar propozimin e palës shqiptare, për të arritur një aleancë ushtarake ndërmjet të dy vendeve, pavarësisht se Ten Hsiao Pini u shpreh gjatë diskutimeve “për vënien e tij në rendin e ditës ... në të ardhmen”⁸.

Më 11 prill 1971, Departamenti i Shtetit udhëzoi Misionin Amerikan në NATO, që të bënin objekt diskutimi problemin e sigurisë së Shqipërisë nga ndonjë sulm i mundshëm i vendeve të Traktatit të Varshavës⁹. Interesi amerikan për Shqipërinë u bë më konkret kur

⁷ NARA, RG 59, Telegram i sekretarit Amerikan të Shtetit, Rogers për ambasadat amerikane në Romë e Beograd, më 24 maj 1971.

⁸ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/AP, V. 1963, D. 7, Takim i Beqir Ballukut me Ten Hsiao Pinin në Pekin, më 24 shtator 1963, f. 81.

⁹ NARA, RG 59, US Mission to NATO, “Presioni i Traktatit të Varshavës mbi Shqipërinë”, 11 prill 1971.

Sekretari Amerikan i Shtetit, Rogers takoi zëvendësministrin e Jashtëm të Greqisë, Palamas në qershor 1971¹⁰. Rogers kërkoi që Ministria e Jashtme e Greqisë, të udhëzonte ambasadorin e vet në Tiranë që t'i bënte të njohur qeverisë shqiptare, gatishmërinë e amerikanëve për të vendosur kanale komunikimi ndërmjet dy palëve, të cilat mund të lehtësonin procesin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Ai theksonte se “qëndrimi i US ndaj Shqipërisë nuk është aspak armiqësor dhe, se ne mezi e presim ditën kur udhëheqësit shqiptarë ta shqyrtojnë me seriozitet përmirësimin e marrëdhënieve me SHBA”¹¹. Qeveria shqiptare nuk iu përgjigj direkt propozimit të amerikanëve, por në një artikull editorial të botuar në gazetën “Zëri i Popullit”, më 26 nëntor 1972 e quajti atë thjeshtë “një balon prove”. Mungesën e reagimit të shqiptarëve ndaj propozimit amerikan, Rogers do ta shpjegonte me stadin e marrëdhënieve amerikano-kineze, të cilat sipas tij ishin në proces evoluimi. Sekretari Amerikan i Shtetit ishte optimist për të ardhmen e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane dhe nuk ndante të njëjtin mendim me diplomatët francezë, të cilët mendonin se principet e politikës së jashtme të Shqipërisë e përjashtonin mundësinë e normalizimit të marrëdhënieve të saj me SHBA.

Në janar 1972, kryetari i shoqatës së pingpongistëve amerikanë, Ranford Harrison, i paraqiti kërkesën për vizë Misionit Shqiptar në New York¹². Ai dëshironte të vizitonte Shqipërinë në muajin korrik, pas vizitës që do të bënte më parë në Jugosllavi. Vizita e tij mendohej se do të përcillte një mesazh të qartë politik, sikurse ishte përcjellë gjatë vizitës së tij në Kinë një vit më parë. Është i njohur gjesti sportiv me natyrë politike i pingpongistëve amerikano-kinezë gjatë takimit të zhvilluar ndërmjet tyre në Japoni në prill 1971, i cili ndihmoi sadopak në shkrirjen e akujve, dhe në përmirësimin e klimës të marrëdhënieve të ngrira disa dhjetjavjeçare ndërmjet të dy vendeve. Por, kërkesa e tij u la në heshtje.

¹⁰ NARA, RG 59, Department of State, POL ALB, Albania 2891, Shqipëria, 7 qershor 1971.

¹¹ NARA, RG 59, Department of State, POL ALB, Albania 2891, Shqipëria, 7 qershor 1971.

¹² *AMPJ*, V. 1972, D. 431, fl. 1-2, Telegram i misionit shqiptar në New York për Ministrinë e Punëve të Jashtme nr. 23, më 14.01.1972; *po aty*, V. 1973, D. 512, fl. 10, “Disa hapa të SHBA në drejtim të normalizimit të marrëdhënieve me RP të Shqipërisë”, New York, 1 maj 1973.

Për udhëheqjen komuniste të Shqipërisë ishte e papranueshme “politika e pingpongut” e amerikanëve, siç e cilësonte atë Enver Hoxha.

Një tjetër ftesë për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë u bë nga ndihmëssekretari Amerikan i Shtetit Kenneth Rush, më 4 prill 1973, në fjalimin e mbajtur në Akademinë Detare në Annapolis. Në paragrafin kushtuar Shqipërisë, Rush theksoi se “vetëm me Shqipërinë nuk ka patur ndonjë progres të dukshëm. Në dritën e zgjerimit të lidhjeve me të gjitha vendet e tjera të Evropës Lindore, duket anakronike që Shqipëria akoma flet për neve me retorikën e kundërshtimit të kohëve të hershme. Por, po të dojë dhe kur të dojë ajo, ne do të na gjejë të përgatitur.”¹³ Propozimi amerikan për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë nuk ishte thjesht një akt formal, një sondazh, apo matje pulsi për të parë reagimin e qeverisë shqiptare. Hapat e mëpasshëm të qeverisë amerikane, tregojnë për seriozitetin dhe ngulmimin e saj, për të normalizuar marrëdhëniet me Shqipërinë. Për arritjen e këtij objekti, qeveria amerikane përdori kanalet diplomatike e jodiplomatike, duke përfshirë edhe disa oferta për shkëmbime shkencore, ekonomike, sportive, kulturore, shtypin, vizitat private të personave me reputacion etj. Qeveria amerikane u informua në mënyrë të veçantë për refuzimin e propozimit të saj, nga misionet diplomatike të Italisë, Jugosllavisë, Francës, Greqisë, Turqisë, Austrisë e Zvicrës në Tiranë, madje edhe më gjerë.

Shkencëtari amerikan me origjinë shqiptare, Sejfi Protopapa, në një letër që i drejtonte kreut të Këshillit Kombëtar të Sigurisë, Henry Kissinger më 11 prill 1973, hidhte idenë e shfrytëzimit të kanaleve personale të komunikimit, si mjet për nxitjen e procesit të përmirësimit të marrëdhënieve me Shqipërinë¹⁴. Në funksion të kësaj ideje, ai i propozoi Departamentit të Shtetit që ta emëronte atë përkohësisht, në përbërje të misionit diplomatik amerikan në Beograd. Por, në përgjigjen e ardhur nga Departamenti i Shtetit, atij i bëhej e qartë kuptimi i fjalës së ndihmëssekretarit Amerikan të Shtetit, Din Rush, sipas së cilës iniciativën duhej ta merrte qeveria shqiptare¹⁵.

¹³ *Po aty*, V. 1973, D. 512, fl. 13-14, Misioni shqiptar pranë Kombeve të Bashkuara në New York për MPJ, 1 maj 1973; NARA, RG 59, “Shqipëria: pozita e shteteve të Bashkuara për njohjen e qeverisë së Tiranës”, përgatitur nga Stephen Peters, 28 dhjetor 1973, f. 18.

¹⁴ NARA, RG 59, Letër e Sejfi Protopapës për Henry Kissinger, 11 prill 1973.

¹⁵ NARA, RG 59, Letër e Richard G. Johnson për Sejfi Protopapën, 17 maj 1973.

Në Departamentin e Shtetit diskutohej edhe për problemet që do të shtroheshin paraprakisht para arritjes së qëllimit final - rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Në fillim të viteve 70 duket se marrëveshjet dypalëshe shqiptaro-amerikane, që kishin qenë në fuqi deri në vitin 1939 dhe ishin bërë pengesë për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike në vitet 1945-1946 e kishin humbur rëndësinë. Ato, ose kishin skaduar në kohë, ose nuk ishin më aktuale. Në këtë kohë, për herë të parë, hasim në diskutimet për pretendimet ekonomike amerikane ndaj Shqipërisë, të cilat duheshin të përmbusheshin nga qeveria shqiptare, pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet të dy vendeve. Së pari, qeveria shqiptare duhej t'i shlyente qeverisë amerikane rreth 2 milionë dollarë amerikanë, si dëmshpërblime për dëmet që u ishin shkaktuar pronave të shtetasve shqiptaro-amerikanë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe së dyti, 10 milionë dollarë të tjerë, për të kompensuar vleftën e pronave të tyre në Shqipëri, të shtetëzuara nga regjimi komunist në vitet e para të pasluftës. Për t'i hapur rrugën procesit të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, në Departamentin e Shtetit mendonin që kjo kërkesë, do të gjente zgjidhje vetëm pas vendosjes së tyre¹⁶. Në fakt kjo kërkesë nuk iu bë e njohur qeverisë shqiptare, për shkak se ajo e refuzoi propozimin amerikan që në hapat e parë. Në lidhje me kërkesën e parë duhet përmendur se, qeveria amerikane ishte përpjekur që ta zgjidhte atë në vitet 1958-1962, kur ajo kishte miratuar një ligj të posaçëm për zhdëmtimin e shtetasve amerikanë me origjinë ballkanike, pronat e të cilëve ishin dëmtuar e shkatërruar gjatë pushtimit italian e gjerman. Nga dokumentacioni i pjesshëm që njohim për këtë problem, na rezulton se, për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga pushtimi italian e gjerman, qeveria amerikane kishte përdorur pasuritë e këtyre shteteve, që gjendeshin në SHBA. Pretendimet amerikane, duke përfshirë edhe ato financiare do të gjenin zgjidhje pas miratimit të një projekt marrëveshjeje të posaçme, të arritur midis qeverive të dy vendeve më 1 gusht 1994.

Diplomacia greke u mundua ta shfrytëzojë në interes të vet propozimin e qeverisë amerikane për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Në vitin 1973, sekretari Amerikan i Shtetit Rogers, hodhi poshtë disa thashetheme të përhapura nga diplomati grek

¹⁶ NARA, RG 59, Memorandum i Departamentit të Shtetit, "Perspektiva e normalizimit të marrëdhënieve me Shqipërinë", 8 mars 1972.

Kavaljeratos, mbi gjoja rolin e ndërmjetësit, që SHBA i kishte ngarkuar Greqisë për vendosjen e urave të komunikimit me Shqipërinë. Rogers bënte të qartë se, Greqia përmes metodave të tilla, donte të informohej më mirë për këtë çështje dhe ta shfrytëzonte atë për interesat e veta kombëtare¹⁷. Diplomati i lartpërmendur grek, duke dashur të shtonte kreditet e tij personale dhe të forcës politike që ai përfaqësonte, shprehej se rivendosja e marrëdhënieve diplomatike të SHBA me Shqipërinë nuk mund të realizohej, sepse, sipas tij vazhdonte të ishte në fuqi rezoluta për “Vorio Epirin” e miratuar në korrik 1946 nga Senati Amerikan. Pretendimi i Kavaljeros u hodh poshtë nga Departamenti i Shtetit.

Disa gazeta të njohura në SHBA si “New York Times”, por edhe shtypi i shqiptarëve të Amerikës nëpërmjet gazetave “Dielli” e “Liria”, botuan artikuj të posaçëm për marrëdhëniet amerikano-shqiptare, duke mbështetur idenë e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Gazetari i njohur amerikan Sulzberger, i cili kishte vizituar Shqipërinë në fund të viteve 50-të, i paraqiti ambasadës shqiptare në Pekin në vitin 1973 kërkesën për vizë, por ajo iu refuzua.

Qeveria amerikane, bëri përpjekje për të komunikuar direkt me Misionin Shqiptar pranë Kombeve të Bashkuara në New York. Por, anëtarët e këtij misioni u treguan të ngurtë dhe shpesh jodiplomatikë në sjellje me diplomatët amerikanë. Ata i zbatuan me përpikëri urdhrat e Ministrisë së Jashtme dhe kriteret ideologjike të gjykimit të shqiptaro-amerikanëve, të cilët u përpoqën që t’i afronin të dy vendet. Disa intelektualëve të shquar të komunitetit shqiptar në SHBA si, Nicholas Costa, Nicholas Pano e Peter Prifti nuk iu dhanë viza, ose ato u lëshuan me shumë vonesë. Historiani Nichola Costa, në shtator 1972 vizitoi selinë e Misionit Shqiptar në New York dhe u përpoq të luante rolin e ndërmjetësit. Ai përcolli një mesazh zyrtar të Departamentit të Shtetit, thelbi i të cilit kishte të bënte me dërgimin në Shqipëri të një përfaqësuesi të qeverisë amerikane [sikurse ishte proceduar edhe me Kinën], për të diskutuar mbi mundësitë e normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve¹⁸. Ai bëri të ditur se, nuk ishte më fjala për sondazhe, por për një mesazh zyrtar të qeverisë amerikane. Por, misioni delikat i profesor Kostës përfundoi pa sukses. Ai ndeshi në refuzimin e prerë dhe në

¹⁷ NARA, RG 59, POL ALB – US, 57812, March 28, 1973, “Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: pyetje nga Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë”, f. 1-2.

¹⁸ AMPJ, V. 1973, D. 512, fl. 23.

sjelljen jo diplomatike [tallëse] të diplomatëve shqiptarë në New York. Të tjerë shqiptaro-amerikanë pas historianit Costa, si Bill Gunari, Dhimitër Trebicka etj., tentuan të bindnin anëtarët e misionit për normalizimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me SHBA, por pa sukses. Departamenti i Shtetit ngarkoi me këtë mision edhe shkencëtarë të shquar amerikanë, por asgjë nuk e ndryshoi qëndrimin e qeverisë shqiptare. Për ta bërë sa më të besueshëm propozimin zyrtar, qeveria amerikane e shoqëroi propozimin me ndërmarrjen e disa hapave konkrete, që kishin si qëllim të përmirësonin klimën e besimit reciprok, për të lehtësuar procesin e nisur. Ndër këto hapa duhet përmendur edhe qëndrimi i rezervuar ndaj emigracionit politik shqiptar në Amerikë, si ndërprerja e ndihmës financiare për Komitetin “Shqipëria e Lirë”, zbutja e retorikës antikomuniste ndaj qeverisë shqiptare etj.

Komuniteti i shqiptarëve të Amerikës e priti me entuziazëm dhe optimizëm propozimin amerikan për normalizimin e marrëdhënieve diplomatike. Në rrethet e tyre qarkullonin zëra se, qeveria shqiptare e kishte “pranuar” propozimin e qeverisë amerikane, dhe kishte caktuar si ambasador të saj në Washington diplomatit me përvojë Javer Malo. Propozimi amerikan zuri vend në disa artikuj të gazetave kryesore amerikane, në të cilat arsyetohej, se zhvillimi i marrëdhënieve ndërmjet SHBA dhe Kinës, do ta vendoste nën presion udhëheqjen shqiptare, e cila do të ndryshonte mendim ndaj SHBA. Më 30 maj 1973, gazeta “Dielli” botonte një artikull të shqiptaro-amerikanit Hari Stoj, i cili, në emër të shqiptarëve të Amerikës falënderonte ndihmëssekretarin Amerikan të Shtetit Keneth Rush dhe Departamentin e Shtetit, të cilët po bënë përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet me Shqipërinë.

Por, në të gjitha rastet, përgjigjet e udhëheqjes shqiptare ishin negative dhe jo të drejtpërdrejta. Enver Hoxha, duke komentuar këto propozime shkruante në ditarin e vet: “Mendoj se nuk kemi pse shpejtohemi të lidhim marrëdhënie me Japoninë. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo se jo, por as me Bonin, as me Anglinë. Kjo të na kthejë arin që na ka grabitur, Boni të na paguajë dëmshpërblimet e luftës. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu si nuk deshën ata të lidhnin marrëdhënie 30 vjet me radhë, edhe ne nuk duam as për 100 vjet”¹⁹. Një përgjigje ndaj propozimit amerikan për rivendosjen e marrëdhënieve

¹⁹ Enver Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1970-1971)*, vëll. VI, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, Tiranë: 1983, f. 454.

diplomatike me Shqipërinë, Enver Hoxha e dha më 3 tetor 1974, në fjalimin e mbajtur me zgjedhësit e zonës elektorale 208, në Tiranë²⁰. Ai e refuzoi propozimin amerikan duke e artikuluar atë me tone mburrjeje dhe aspak diplomatike.

Qëndrimi refuzues i udhëheqjes shqiptare sipas diplomatit e studiuesit Stephen Peters*, duhet kërkuar tek bazat e politikës së jashtme të Shqipërisë, të tilla si: ruajtja e pandryshuar e pushtetit politik, tek parimet ideologjike staliniste, por edhe përpjekjet për të siguruar mbijetesën kombëtare dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë.²¹

Në vitet në vazhdim qeveria amerikane nuk do ta humbiste interesin për Shqipërinë. Ajo do ta linte të hapur derën për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me të. Në maj 1974, gjatë një takimi të NATO-s në Bruksel, u diskutua edhe për gjendjen e Shqipërisë dhe për pozitën e saj strategjike në Mesdhe, duke vlerësuar politikën e asnjësisë ndaj dy Blloqeve Ushtarake, të ndjekur nga qeveria shqiptare e cila favorizonte NATO-n. Në samit u hodh ideja se nuk duhej të krijoheshin acarime me Shqipërinë, por duheshin përmirësuar marrëdhëniet me të. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia duhej të vazhdonin më tej përpjekjet e tyre për të arritur që të vendosnin marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë.

Shpresa e qeverisë amerikane se politika kineze do të ndikonte në rivendosjen e lidhjeve shqiptaro-amerikane nuk u përlligj. Udhëheqja komuniste e Shqipërisë nuk e pëlqeu afrimin kinezo-amerikan dhe nuk u pajtua me politikën kineze të hapjes me botën. Tirana zyrtare vazhdoi propagandën e saj kundër dy superfuqive dhe i mbajti dyert të mbyllura, pavarësisht nga përpjekjet e shumëllojshme të SHBA-së për të vendosur ura komunikimi me Shqipërinë. Në vitet 70-të tregtia ndërmjet dy vendeve mbeti në nivele shumë të ulëta, thjesht në disa shkëmbime të pakta në vlerë dhe në llojshmëri. Në vitin 1974 rrethet politike e financiare të SHBA-së i propozuan Shqipërisë dhënien e një huaje prej

²⁰ Enver Hoxha, "Imperializmi amerikan dhe imperializmi rus po e çojnë botën në një luftë tjetër botërore më të tmerrshme nga të gjitha të tjerat", në *Zëri i Popullit*, nr. 238 (8156), 4 tetor 1974.

* *Stephen Peters* ishte qytetar amerikan me origjinë shqiptare, i cili kishte kryer studimet universitare në Harvard. Pas Luftës së Dytë Botërore punoi në Departamentin e Shtetit dhe u mor me çështjet e Ballkanit dhe të Shqipërisë.

²¹ NARA, RG 59, R/RSES-2 Department of State, "Shqipëria: Ndryshimet e politikës së jashtme", përgatitur nga Stephen Peters, 4 janar 1972.

100 milion dollarë, me afat 20 vjeçar dhe me interes 7.5%, por që mbeti pa përgjigje. Misioni shqiptar në New York pati disa ftesa dhe informacione nga institucione të larta të SHBA-së për të marrë pjesë në disa evenimente të rëndësishme, por që u refuzuan në heshtje prej tij. Pas shumë vitesh, në mars 1977 qeveria amerikane i hoqi kufizimet e vendosura për lëvizjen e anëtarëve të Misionit Shqiptar në New York.

Propozime në adresë të qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në këtë kohë u bënë edhe nga qeveritë e Britanisë së Madhe, të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Japonisë.

Shqipëria bënte pjesë në grupin e atyre shteteve me të cilat Britania e Madhe nuk kishte as përfaqësues diplomatik dhe as marrëdhënie normale. Por, pas prishjes së marrëdhënieve me BS dhe Bllokun Komunist, qeveria angleze ndoqi një politikë më të përcaktuar ndaj Shqipërisë. Në janar 1962, Foreign Office [FO] korrigjoi diçka në politikën e vet. Në një komunikatë konfidenciale, në lidhje me politikat që FO duhet të ndiqte ndaj vendeve të tilla si Shqipëria, Republika Demokratike Gjermane, Republika Demokratike e Koresë dhe Vietnami, bëhej një dallim për Shqipërinë dhe për Arabinë Saudite. Tashmë, FO shpallte se nuk do t'i pengonte më përfaqësuesit e saj diplomatikë, që të komunikonin direkt, apo përmes ndërmjetësve me përfaqësues diplomatikë të këtyre dy shteteve Por, Ministria e Jashtme angleze i ndalonte përfaqësuesit e saj, që të përgjigjeshin direkt dhe të vendosnin për çështje të ndryshme, pa u njohur më parë me gjykimin e qeverisë së tyre²².

Në vitin 1965, me nxitjen e sekretarit të shoqatës Angli-Shqipëri, William Bland, disa anëtarë të veçantë të parlamentit hodhën idenë e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duke e argumentuar këtë si hap në favor të palës britanike²³. Por, qeveria shqiptare iu përmbajt pikëpamjes se, vendosja e marrëdhënieve diplomatike ishte një çështje që u takonte ta zgjidhnin qeveritë e dy vendeve dhe jo persona, apo shoqata miqësie. Në rast se qeveria angleze, do të kishte propozime konkrete, ajo duhej t'i paraqiste ato nëpërmjet kanaleve diplomatike. Më 1967, pas 27 vjetësh, BBC e ndërpreu

²² *The National Archives, London* (më tej: TNA), "Komunikime me qeveri, marrëdhëniet e të cilëve me qeverinë e Madhërisë së Saj në Britaninë e Madhe nuk janë në kushte normale", qarkore nr. 053 Foreign Office, 18 qershor 1962.

²³ *AQSH, F. 14/AP, V. 1966, D. 201, fl. 1-2.*

transmetimin në gjuhën shqipe, duke e motivuar këtë veprim me mungesën e burimeve financiare, por edhe të interesit të pakët që paraqiste Shqipëria. Përpjekjet e lordit Nicholas Bethel, në vitin 1972, për të rivendosur shërbimin e BBC me Shqipërinë, FO i gjykoi si një veprim pa interes²⁴.

Qeveria britanike ndiqte gjithashtu edhe trendin e zhvillimeve amerikano-shqiptare, i cili nuk mund të thuhet se ndikonte në sjelljen e saj ndaj Shqipërisë. Ministria e Jashtme Britanike ndiqte po kështu me vëmendje, zhvillimet e reja dhe situatën që u krijua pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, në gusht 1968, duke e konsideruar këtë si një hap pozitiv të saj dhe në favor të vendeve perëndimore. Diplomacia britanike gjykonte se, përderisa Shqipëria do të vazhdonte të qëndronte ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit dhe do të ruheshin ekuilibrat ekzistues, nuk do të kishte ndonjë arsye madhore apo motiv nxitës, i cili do ta detyronte atë që të ndryshonte politikën e vet ndaj Shqipërisë dhe as që ta shihte me përparësi problemin e marrëdhënieve me Shqipërinë. Megjithëkëtë, Britania e Madhe vazhdoi të zhvillonte shkëmbime të vogla tregtare dhe të nxiste disa kompani të saja, që të ishin të pranishme në Shqipëri. Shkëmbimet tregtare arrinin në disa qindra mijëra paund, ndërsa Shqipërinë e vizituan një numër i vogël turistësh anglezë.

Në vitin 1969, një vit pas daljes zyrtarisht të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Suedinë dhe disa vende të tjera perëndimore, në rrethet diplomatike britanike u hodh ideja e shqyrtimit të marrëdhënieve me Shqipërinë, dhe e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me të. Por, qeveria britanike në një memorandum të posaçëm të saj, arrinte në konkluzionet se, “në situatën aktuale, ajo nuk duhej të merrte iniciativën për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë”; se “ajo mund ta rivlerësonte situatën vetëm nëse shqiptarët do të jepnin ndonjë sinjal të vërtetë për zhvillimin potencial turistik të vendit të tyre, apo nëse do të vihej re ndonjë ndryshim radikal në qëndrimin ushtarak e politik të saj”²⁵. Për të arritur në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duhej të zgjidhej në mënyrën më të mirë kompensimi i anglezëve për Incidentin e Kanalit të Korfuzit. Për herë të parë u hodh ideja që në të njëjtën kohë

²⁴ TNA, *Foreign and Commonwealth Office* (më tej: FCO) 26/1200, Year 1972.

²⁵ TNA, FCO 28/613, 1968-1969, “Shqipëria”, Konfidenciale, teper sekret, J. W. Hutson për zotin T. Brimelow, 26 gusht 1969.

me zgjidhjen e problemit të dëmshpërblimit për Anglinë, t'i kthehej edhe Shqipërisë ari monetar i bllokuar. Por, qeveria angleze gjykonte se ende nuk kishte ardhur koha për të ndërmarrë një iniciativë të tillë.

Përpjekjet e qeverisë britanike për të rivendosur marrëdhënie diplomatike me qeverinë shqiptare u shtuan në mënyrë të veçantë në vitet 1972-1973, duke ndjekur propozimet e qeverisë amerikane për afrim me Shqipërinë dhe situatën në përmirësim të marrëdhënieve të Kinës me SHBA dhe Evropën Perëndimore. Sinjalin e parë e kishte dhënë zëvendës Sekretari i Jashtëm Britanik më 24 prill 1972, i cili kishte deklaruar në Dhomën e Komuneve se “do të isha i lumtur nëse do të ishim në gjendje të gjenim rrugën për të kaluar vështirësitë, të cilat kanë penguar rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë”²⁶. Në vitin 1973, qeveria angleze i shpeshtoi përpjekjet për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Ajo kontaktoi me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, e cila pranoi të ndërmjetësonte midis të dy palëve, për të ndihmuar këtë proces. Britanikët mendonin se, nëse do të gjenin gatishmërinë e palës shqiptare, do të procedonin më tej me fillimin e bisedimeve në Romë ose në New York²⁷. Sekretari britanik për Punët e Jashtme, Julian Emery [ish-oficer i SOE-s në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore] u kujdes personalisht për mbarëvajtjen e procesit të nisur. Për të bërë të njohur propozimin britanik, përveç ambasadorit italian në Tiranë, u shfrytëzuan edhe diplomatët turq e kinezë²⁸. Qeveria shqiptare nuk e refuzoi propozimin e britanikëve, sikurse kishte vepruar me atë të qeverisë amerikane, por ajo nuk pranoi të fillonte bisedimet, pa zgjidhur më parë problemin e arit monetar shqiptar. Në fjalimin elektoral të 3 tetorit 1974, Enver Hoxha e bëri të qartë se, nuk mund të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike me Britaninë e Madhe, pa i kthyer më parë Shqipërisë të gjithë arin e “vjedhur”, së bashku me interesat.

Qeveria britanike në vitin 1977 ndiqte me vëmendje të veçantë kursin negativ të marrëdhënieve shqiptaro-kineze dhe perspektivën e ndryshimit të tyre²⁹. Pavarësisht nga zgjerimi i marrëdhënieve diplomatike dhe

²⁶ AMPJ, V. 1973, D. 253, Informacion i Ksenofon Nushit-zëvendësministër i Punëve të Jashtme, më 5 shkurt 1973.

²⁷ AMPJ, V. 1973, D. 253, Informacion i Ksenofon Nushit, më 3 shkurt 1973.

²⁸ *Po aty*, fl.12-13, Informacion i ministrit të Punëve të Brendshme Kadri Hazbiu, nr. 4315, më 31.08.1973.

²⁹ TNA, FCO 21/560, Year 1977, “Shpresë për ndryshime në politikën e jashtme të Shqipërisë”, 5 gusht 1977.

ekonomike të Shqipërisë me disa vende fqinje dhe ato perëndimore, Enver Hoxha konsiderohej, si “ i burgosur fanatik i ideologjisë së vet, si një person paranojak, i përcaktuar për të garantuar sundimin e tij personal”. Ai, shihej si një udhëheqës, që nuk ishte në gjendje të ndiqte evolucionin e politikës së jashtme të Mao Ce Dunit, por si një drejtues që kishte hyrë në një garë [me kinezët], për të siguruar udhëheqjen e lëvizjes marksiste-leniniste në botë. Në Foreign and Commonwealth Office* (FCO) mendonin se, prishja e marrëdhënieve shqiptaro-kineze ishte një fenomen i pritshëm, i cili do të shoqërohej me ndryshime në politikën e jashtme të Shqipërisë. E ardhmja e saj do të ishte rruga e vetizolimit dhe e mbështetjes në forcat e veta. Kthimi i Shqipërisë në orbitën e Bashkimit Sovjetik apo kërkimi i një “mbrojtësi të ri”, gjykohej si një fenomen, që do të ishte i vështirë të ndodhte. Ndjekja e kursit të vetizolimit do t’i shteronte rezervat e Shqipërisë dhe herët a vonë, ajo do të detyrohej të lëvizte ngadalë drejt Evropës Perëndimore dhe tregtisë botërore³⁰.

Duke pasur në konsideratë trashëgiminë dhe barrierat ideologjike e ligjore të shtetit shqiptar, parashikohej që lëvizja e Shqipërisë drejt Perëndimit do të ecte në tri shina kryesore, të cilat përfshinin tregtinë e jashtme, forcimin e lidhjeve me vendet fqinje ballkanike e Italinë, dhe pjesëmarrjen e saj në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë*. Nëse do të ndodhnin ndryshimet e supozuara, qeveria angleze do të duhej t’i jepte Shqipërisë një sinjal të qartë të dëshirës së saj për të normalizuar marrëdhëniet dypalëshe. Si hap i parë, do të shërbente dërgimi në Shqipëri i një misioni, i cili do të njihej me prirjet e politikës

* *Foreign and Commonwealth Office* (FCO) është një nga ministritë e Mbretërisë së Bashkuar, e cila u krijua në vitin 1968 nga bashkimi i Foreign Office (FO) dhe Commonwealth Office. Kjo ministri është përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e interesave britanike në mbarë botën. FCO drejtohet nga Sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme të Commonwealth-it, që shkurt thirret - Sekretari i Shtetit. Posti i Sekretarit të Shtetit vlerësohet si një ndër katër emërimet më prestigjioze të Kabinetit Britanik.

https://en.wikipedia.org/wiki/Foreign_and_Commonwealth_Office (klikuar më 15 tetor 2016)

³⁰ TNA, FCO 21/560, Year 1977, “Shpresë për ndryshime në politikën e jashtme të Shqipërisë”, 5 gusht 1977.

* *Shënim*: Në fakt dy parashikimet e para u vërtetuan, ndërsa pjesëmarrja e Shqipërisë në KSBE mbeti një “mollë e ndaluar” deri në maj të vitit 1990, kur Shqipëria u pranua me statusin e vëzhguesit dhe një vit më vonë, si vend anëtar me të drejta të plota.

shqiptare dhe me zhvillimin e dyanshëm të tregtisë. Mundësitë aktuale të Britanisë së Madhe për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë dukeshin të pakta, por sidoqoftë, shpresohej që Enver Hoxha në rrethana të tjera, do të detyrohej të tregohej më fleksibël për problemin e arit shqiptar. Nëse qeveria shqiptare do të tregonte shenja elasticiteti për problemin e arit, qeveria britanike duhej t'i përgjigjej shpejt, për ta zgjidhur këtë problem përmes bisedimeve. Në FCO gjykonin se rëndësia e Shqipërisë për Britaninë e Madhe dhe Perëndimin në përgjithësi ishte e pakët, deri sa ajo ruante pavarësinë dhe do të qëndronte jashtë kontrollit sovjetik. Në të kundërt, prania e sovjetikëve në Shqipëri do të shoqërohej me pasoja të papëlqyeshme për Perëndimin dhe zhbërjen e ekuilibrit ekzistues, ndërsa avantazhi strategjik do t'i kalonte BS. Pakësimi i interesit kinez për Shqipërinë, apo tërheqja e tyre, do ta shtonte presionin mbi politikën e brendshme e të jashtme të qeverisë shqiptare dhe do të sillte ndryshime në qeverisjen e saj. Gradualisht, Shqipëria do të hapej drejt Perëndimit.

Qeveria shqiptare në fillim të viteve 70-të u njoh gjithashtu me sondazhet dhe me kërkesën e Republikës Federale Gjermane për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Dukej se zhvillimet e reja politike që po përjetonte Kontinenti Evropian, si “Detanta”, përmirësimi i marrëdhënieve Lindje-Perëndim, projektimi i Konferencës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike të Kinës me RFGJ, do ta çonin edhe Shqipërinë drejt përmirësimit të marrëdhënieve me këtë vend. Në vitin 1972, ambasadat shqiptare në Vjenë e në Pekin i përcollën Ministrisë së Punëve të Jashtme mesazhin e diplomatëve gjermano-perëndimorë për të vendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë³¹. Por, iniciativa gjermane nuk gjeti konkretizim, sepse qeveria shqiptare vuri si kusht paraprak zgjidhjen e problemit të reparacioneve të Luftës dhe pastaj të procedohej për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Qeveria gjermano-perëndimore u njoh me pretendimin shqiptar për reparacionet [i cili e kalonte shumën e 2 miliard dollarëve amerikanë të vitit 1938], më 28 shtator 1973, gjatë sesionit të 28 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara³². Pas këtij hapi, qeveria shqiptare ngarkoi disa ministri të përgatisnin një

³¹ AMPJ, V. 1972, D. 300.

³² AQSH, F. 14/AP, fl. 1, “Informacion mbi reparacionet nga Gjermania”, Mehmet Shehu drejtuar Enver Hoxhës, më 7 shkurt 1974.

studim për historinë e këtij problemi dhe për shumën e dëmshpërblimeve që do t'i kërkoheshin RFGJ, duke i shtuar shifrës së lartpërmendur edhe dëmet që u ishin shkaktuar personave fizikë [të vrarë, të plagosur, të internuar, si dhe punën e papaguar të kategorisë së fundit]. Me gjithë vështirësitë që krijonte mungesa e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet të dy vendeve, qeveria shqiptare shprehu gatishmërinë për të biseduar drejtpërdrejt [pa ndihmën e një ndërmjetësi] me palën gjermane³³. Por, për disa kohë procesi i afrimit mbeti i ngrirë, sepse qeveria gjermano-perëndimore e konsideronte kërkesën shqiptare të papajtueshme me marrëveshjen e Londrës të vitit 1953, e cila e kushtëzonte zgjidhjen e pretendimeve për reparacione me nënshkrimin e Traktatit të Paqes me Gjermaninë³⁴. Me gjithë refuzimin e qeverisë shqiptare se, ajo nuk ishin palë nënshkruese e Traktatit të Londrës dhe se vendimet e saj nuk ishte detyruese për Shqipërinë, qeveria gjermane nuk u tërhoq nga qëndrimi i vet, duke deklaruar se ajo ishte detyruese për Gjermaninë. Shuma e kërkuar nga qeveria shqiptare si reparacione lufte prej Gjermanisë ishte tejet e ekzagjeruar dhe aspak realiste. Më 28 qershor 1975, ajo i kërkoi palës gjermane dëmshpërblime që arrinin në 4,5 miliard dollarë³⁵. Diplomacia shqiptare i vlerësoi si të dëmshme për Republikën Demokratike Gjermane [RDGJ] Traktatet Bon-Moskë të vitit 1971 dhe marrëveshjen ndërmjet dy Gjermanive³⁶, të cilët i hapën rrugë procesit të njohjes së kufijve të RDGJ, njohjes së saj ndërkombëtare, por edhe zbutjes së tensioneve Lindje-Perëndim. Enver Hoxha kritikoi edhe Konferencën e Helsinkit, sepse, sipas tij, ajo “dëmtoi” interesat e RDGJ dhe nuk e zgjidhte problemin gjerman. Por, në fakt, një nga nenet e Kartës së Helsinkit pranonte bashkimin paqësor dhe ndryshimin e kufijve pa dhunë ndërmjet shteteve, i cili i hapte rrugë edhe bashkimit të dy Gjermanive. Ky nen u miratua me insistimin e veçantë të përfaqësuesve

³³ *Po aty*, fl. 5-6.

³⁴ Matthias Dornfeldt, Enrico Weewald, “Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike mes Republikës Federale Gjermane dhe Republikës Popullore të Shqipërisë”, në *Shqipëria në Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Tiranë: AIS, 2013, f. 272-273.

³⁵ *Po aty*, f. 272; Hamit Kaba, “Dëmshpërblimet gjermane të Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë (1945-1990), në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2001.

³⁵ TNA, FCO 21/560, Year 1977, “Shpresë për ndryshime në politikën e jashtme të Shqipërisë”, 5 gusht 1977.

³⁶ *AMPJ*, V. 1971, D. 670, fl. 167-121, Relacion i ambasadorit shqiptar nga Beogradit, Dhimitër Lamani për MPJ, nr. 27/9, 21.09.1971.

të RFGJ në Helsinki, por edhe të vendeve të tjerë perëndimorë, duke përfshirë SHBA dhe Francën.

Zhvillimet politike të Shqipërisë pas prishjes me Kinën në verën e vitit 1978 vërtetuan hipotezat e ngritura në studimin e lartpërmendur të FO për zhvillimet e Shqipërisë pas prishjes me Kinën. Ndërprerja e ndihmave ekonomike dhe ushtarake të Kinës në vitin 1978 e la Shqipërinë pa një mbështetje të madhe ndërkombëtare dhe pa burime të mjaftueshme ekzistenciale. Për herë të parë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria do të mbijetonte në vitet në vazhdim pa një vend të madh aleat. Politika e ndjekur nga qeveria shqiptare e izoloi edhe më tej vendin, pavarësisht se ajo u mundua të kontrollonte me rreptësi çdo burim të brendshëm, duke zbatuar parimin e ‘mbështetjes tërësisht në forcat e veta’, duke i bërë thirrje ndërgjegjes dhe krenarisë kombëtare të shqiptarëve dhe, duke pretenduar se ishte vendi më puritan marksist-leninist.

Pavarësi dhe vetizolim (1979 -1990)

Prishja e marrëdhënieve shqiptaro-kineze në korrik 1978 dhe gjendja e krijuar në Shqipëri u prit me shqetësim në Perëndim. Departamenti i Shtetit e shtoi interesin për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj politike e ekonomike. Shtypi amerikan, që përcillte deri diku edhe opinionet zyrtare të politikës amerikane, ndiqte me kujdes dhe bënte prognoza për zhvillimet e ardhshme në Shqipëri. Fillimisht pati shpresa se Shqipëria mund të afrohej me Perëndimin dhe me SHBA, por udhëheqja staliniste e Shqipërisë zgjodhi rrugën e refuzimit të marrëdhënieve si me SHBA ashtu edhe me Bashkimin Sovjetik. Dyshim dhe shqetësim për politikën amerikane përbënte sidomos afrimi i mundshëm i Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe rikthimi i saj në Bllokun Komunist dhe në Traktatin e Varshavës. Një alternativë e tillë do të kërcënonte pavarësinë e Shqipërisë dhe do ta vendoste SHBA në pozita të disfavorshme, sepse do të prishte ekuilibrat e krijuara në Evropë dhe do të dëmtonte krahun juglindor të NATO-s, duke e bërë më të brishtë mbrojtjen e Greqisë dhe të Italisë³⁷. Në rrethanat e krijuara, SHBA i shtuan përpjekjet për t'u njohur me zhvillimet brenda vendit, me ekonominë dhe orientimin politik

³⁷ AMPJ, V. 1979, D. 730, fl. 6, Relacion i Abdi Baletës nga New York-u për MPJ, 2 gusht 1979.

të Shqipërisë³⁸, me shkallën e influencës sovjetike, me aftësitë ushtarake dhe vendosmërinë e saj, për t'u përballur me një agresion të mundshëm të Bashkimit Sovjetik, vetëm apo me Jugosllavinë³⁹.

Në shërbim të kësaj politike u morën disa veprime zyrtare për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike; u nxitën vendet perëndimore për t'u afruar me Shqipërinë [sidomos Republika Federale Gjermane e Britania e Madhe]; u bënë përpjekje për t'i ofruar Shqipërisë ndihma ekonomike, financiare e teknologjike; u aktivizua organizata e Atlantikut të Veriut për të analizuar situatat hipotetike që mund të krijoheshin nga ndonjë sulm i BS e i Traktatit të Varshavës ndaj Shqipërisë etj. Në shkurt 1981, në televizionin amerikan rifilloi programi në gjuhën shqipe, ndërsa një vit më pas, disa albanologë shqiptaro-amerikanë, me në krye Nikolla Panon krijuan Qendrën e Studimeve Shqiptare⁴⁰. Anëtarë të kësaj Qendre, si Sami Repishti, Nikolla Pano, Peter Prifti etj., botuan artikuj kritikë ndaj pretendimeve të lobit grek në Amerikë, për trajtimin “veçanërisht të keq” dhe të “diferencuar”, që i bëhej minoritetit grek në Shqipëri, për shtimin e ekzagjeruar të numrit të minoritarëve grekë në Shqipëri etj. Disa nga pretendimet e padrejta të lobit grek zunë vend edhe në raportet zyrtare të Departamentit të Shtetit.

Komuniteti shqiptar në SHBA e përqafoi dhe e mbështeti fort idenë e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Në gazetën “Dielli” dhe “Liria” u shkruan disa artikuj që i bënë jehonë kësaj ideje. SHBA [sipas shtypit amerikan] mbështetën demonstratat e shqiptarëve dhe kërkesën e tyre kryesore “Kosova Republikë”.

Në SHBA dhe në Perëndim lindi ideja e krijimit të një “korridori mbrojtës diplomatik” për Shqipërinë. Në prill 1980 ndihmëssekretari Amerikan i Shtetit Robert Barry, shprehu gatishmërinë e Departamentit të Shtetit për të vendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë⁴¹. Disa senatorë, kongresmenë e zyrtarë të lartë amerikanë bënë përçapje për të

³⁸ *Po aty*, V. 1979, D. 742, Telegram i Nesipit nga Bukureshti për MPJ, nr. 1718, më 6 dhjetor 1979.

³⁹ Paskal Milo, “Politika e Jashtme e Shqipërisë në vitet 1980-1990”, në *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Tiranë: Toena, 2009, f. 331.

⁴⁰ *AMPJ*, V. 1982, D. 1212, fl. 4, Telegram i Abdi Baletës nga New Yorku për MPJ dhe Ramiz Alinë. Shoqata e Studimeve Shqiptare sipas Nikolla Panos kishte 54 albanologë shqiptarë, ndërmjet të cilëve edhe Elez Biberaj.

⁴¹ *AMPJ*, V. 1980, D. 744, fl. 15, Telegram i Misionit Shqiptar në Budapest për MPJ, më 19 qershor 1980.

vizituar Shqipërinë dhe për të “shtruar rrugën” për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet të dy vendeve. Vullnet të veçantë tregoi në këtë drejtim senatori Claiborne Pell [anëtar i Komitetit të Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë], i cili duke filluar nga viti 1977 e në vazhdim kontaktoi disa herë me misionin e Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara në New York dhe me disa misione të tjera në Evropë. Në letrën që i dërgoi personalisht Enver Hoxhës në vitin 1978, senatori amerikan nënvizonte nevojën për fillimin e bisedimeve dypalëshe, që do të çonin në rivendosijen e marrëdhënieve diplomatike. Ai shprehu dëshirën për të bërë një “vizitë private” në Shqipëri. Por, si letra ashtu edhe përpjekjet e senatorit amerikan mbetën pa përgjigje. Senatori amerikan, jo vetëm që nuk përfitoi një vizë shqiptare, por u përball edhe me sjelljet fyese dhe aspak diplomatike të disa përfaqësuesve të rëndësishëm të diplomacisë shqiptare në botë⁴².

Në mars 1982, nënsekretari i Departamentit të Shtetit, Scalan, iu rikthye sërish idesë së vendosjes së kontakteve me Shqipërinë. Ndërsa ish presidenti Nixon në korrik 1982 kërkoi ndërmjetësinë e Çaushekut për të vizituar Shqipërinë, me qëllim që të normalizonin marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve⁴³. Ministria e Punëve të Jashtme, duke marrë shkas nga këto oferta, në janar-gusht të vitit 1982 u dërgoi disa qarkore përfaqësive diplomatike shqiptare, në të cilat njoftonte se kohët e fundit SHBA “kanë intensifikuar përpjekjet e tyre për të hyrë në kontakt me vendin tonë, përfaqësuesit zyrtarë amerikanë kanë bërë përcapje direkte për të vizituar Shqipërinë”⁴⁴. Ajo i porosiste që të studionin “mirë çdo hap të SHBA drejtuar vendit tonë dhe reagimet e Perëndimit” dhe të theksonin qëndrimin e njohur ndaj tyre, të përcaktuar nga Enver Hoxha, “duke nënvizuar se asgjë nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë në qëndrimin tonë ndaj tyre”⁴⁵.

⁴² *Po aty*, V. 1980, D. 746, fl. 7-10, Telegram i Abdi Baletës nga New Yorku drejtuar MPJ, nr. 42, më 11 janar 1979. Në letrën që Claiborne Pell i dërgoi Abdi Baletës, më 1 janar 1979 vihet në dukje një fakt interesant: Pell pretendonte, se në vitin 1946 ai ishte emëruar nga Departamenti i Shtetit si sekretar i tretë në ambasadën amerikane, që do të vendosej në Tiranë. Por, meqenëse ajo nuk u hap, Pell u emërua në Pragë.

⁴³ *AMPJ*, V. 1982, D. 830, fl. 67, Telegram i Reiz Maliles drejtuar të gjitha përfaqësive shqiptare, më 2 korrik 1982.

⁴⁴ P. Milo, “Politika e Jashtme e Shqipërisë ...”, f. 331-332.

⁴⁵ *Po aty*, f. 332.

Disa gazeta amerikane shkruajtën për interesimin dhe për ofertat e bëra nga disa kompani e banka amerikane, për t'i dhënë Shqipërisë kredi, ndihma e teknologji, për kërkime në zona naftëmbajtëse e për minerale. Një ofertë u ofrua nga një kompani amerikane për të furnizuar me teknologji edhe kombinatin metalurgjik të Elbasanit në ndërtim e sipër⁴⁶. Duke ndeshur në refuzimin e qeverisë shqiptare dhe duke i njohur nevojat e saj të mëdha për partneritet ekonomik e tregtar, qeveria amerikane nxiti vendet perëndimore për të bashkëpunuar me Shqipërinë.

Duke filluar nga viti 1980 qeveria amerikane [përmes kanaleve të ndryshme diplomatike], bëri të njohura pretendimet e saj financiare ndaj Shqipërisë. Ato kishin të bënin me shpronësimet e papaguara të qeverisë shqiptare pas mbarimit të luftës. Këto kërkesa do të përfshiheshin në vitin 1984 në 'propozimin prej 7 pikash', të paraqitura nga ambasadori francez në Tiranë⁴⁷ [i cili luajti rolin e ndërmjetësit] dhe në bisedimet shqiptaro-angleze të viteve 1985-1987. Por, qeveria shqiptare për shumë vite nuk i njohu këto pretendime dhe nuk pranoi t'i diskutonte ato në bisedimet e zhvilluara me palën angleze në vitet 1985-1987.

Në mungesë të një alternative më të mirë, por pa hequr dorë nga kërkesa për afrim me Shqipërinë, SHBA e vlerësuan si të pranueshëm kursin aktual që ndiqte udhëheqja shqiptare në mesin e viteve 80-të për ruajtjen e pavarësisë së vendit dhe refuzimin e saj, për t'u rikthyer në "familjen" e vendeve komuniste. "Futja përsëri e BS në Shqipëri, deklaronte Marc Palmer [zëvendëssekretar i Departamentit të Shtetit] në nëntor 1984, do të kërcënonte pavarësinë e saj, prandaj është në interesin e Shqipërisë, që të ruajë e mbrojë qëndrimin e saj të pavarur, dhe të mos bëhet bazë agresioni ushtarak sovjetik në atë pjesë të botës"⁴⁸.

SHBA nuk e humbën interesin për Shqipërinë edhe pas vdekjes së Enver Hoxhës dhe ardhjes në pushtet të Ramiz Alisë. Qeveria amerikane ndiqte me kujdes zhvillimet e Shqipërisë, duke pasur dyshime për politikën e saj të ardhshme ndaj BS dhe aleatëve të tij. Shqetësimi i amerikanëve lidhej sërish me mundësinë e rikthimit të Shqipërisë në orbitën e Moskës dhe prishjen e ekuilibrave të vendosur në rajon. Në këto kushte, qeveria amerikane vazhdoi të përcillte mesazhe për t'u afruar me

⁴⁶ AMPJ, V. 1980, D. 746, fl. 17.

⁴⁷ Ksenosfon Krisafi, *Në kërkim të Arit*, Tiranë: Dita 2000, 2000, f. 178-179.

⁴⁸ AMPJ, V. 1985, D. 872, f. 108, Informacion i Justin Papajorgjit nga New York-u për MPJ, më 29 qershor 1985.

Shqipërinë. Vetëm një ditë pas vdekjes së Enver Hoxhës në Departamentin e Shtetit u deklarua, se “në qoftë se Shqipëria dëshiron të vendosë marrëdhënie diplomatike, neve do të na gjejë të përgatitur për t’u përgjigjur”⁴⁹.

Ramiz Alia u cilësua nga amerikanët si “një person më i moderuar, me të cilin mund të bisedohet me kalimin e kohës për zbutjen e marrëdhënieve”⁵⁰. Gjithashtu, u ushqyen shpresa se Shqipëria do të lëvizte ngadalë drejt Perëndimit, në mënyrë të veçantë me vendet fqinje, Britaninë e Madhe e RFGJ. Por, Ramiz Alia në gusht 1985 ua mbylli derën amerikanëve, kur deklaroi se Shqipëria nuk ka e nuk do të ketë asnjë marrëdhënie me SHBA. Sidoqoftë, ai nuk e ktheu vendin në Kampin Komunist, ndonëse ftesat nuk i munguan nga udhëheqësi i ri i BS - Gorbaçovi. SHBA dhe Perëndimi e vlerësuan qëndrimin mospajtues të Tiranës ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të Bllokut Komunist pas vdekjes së Enver Hoxhës.

Në vitin 1985, shtypi amerikan shkroi edhe për operacionet e fshehta anglo-amerikane për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri në vitet 1949-1953 dhe për efektet e tyre negative në afrimin e dy vendeve. Qeveria shqiptare e përdori politikisht dhe ekonomikisht këtë fakt, duke folur për koston që kishte pësuar Shqipëria nga operacionet anglo-amerikane, dhe ua kundërvuri ato pretendimeve ekonomike e financiare të SHBA. Pavarësisht nga ulja e tensionit, Departamenti i Shtetit vazhdoi të mbante qëndrim kritik ndaj shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri. Por, shtimi i pajustificuar i numrit të minoritetit grek në Shqipëri, i orkestruar nga lobi grek në Amerikë u përball sërish me kritikën e shqiptaro-amerikanëve. Shqipëria vazhdoi të përballej me kritika të rrepta për mungesën e lirive dhe të drejtave të njeriut, për mungesën e lirive të besimit dhe të institucioneve fetare, të ndaluar që në vitin 1967. Por, nuk mungonin zërat që vinin në dukje se në Shqipëri, në vitin 1987, po vihej re një farë zbutjeje e fushatës antifetare. Por, aktivitetet religjioze vazhdonin të mbeteshin të ndaluara. Në rrethet drejtuese shtetërore të Shqipërisë u vlerësuan pozitivisht rezolutat e paraqitura në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në

⁴⁹ *Po aty*, fl. 109.

⁵⁰ *Po aty*, fl. 62, Telegram i Justin Papajorgjit nga New York-u për MPJ, më 15 prill 1985.

Senat, nga senatorët Xhozef Dioguardi dhe Bob Doll për shtypjen e shqiptarëve në Jugosllavi⁵¹.

Fillimi i bisedimeve të qeverisë shqiptare me Britaninë e Madhe e RFGJ në gjysmën e dytë të viteve 80-të, tregoi se regjimi komunist po bënte disa hapa të druajtura dhe të detyruara drejt Perëndimit. Në vitin 1987, Shqipëria vendosi marrëdhënie diplomatike me RFGJ dhe me Kanadanë⁵². Tirana zyrtare dha disa shenja të vogla ndryshimi në raportet me SHBA. Diplomatët shqiptarë, siç përmend profesor Paskal Milo, hoqën dorë nga sjellja aspak diplomatike e refuzimit për t'u dhënë dorën e kthyer shpinën homologëve amerikanë⁵³. Gjatë vitit 1989, qeveria shqiptare i la në heshtje kërkesat e disa personave të rëndësishëm të SHBA për të vizituar Shqipërinë, ndërmjet të cilëve ato të ish kongresmenit me origjinë arbëreshe, Xhozef Dioguardi, Joe Kennedy⁵⁴ [djali i Robert Kennedit] etj.

Ndryshimeve kozmetike të Ramiz Alisë iu erdhi fundi nga ngjarjet e zhvilluara në Evropën Lindore e Qendrore dhe sidomos nga fundi i përgjakshëm i Çausheskut në Rumani. Në plenumin e muajit prill 1989 të Komitetit Qendror të PPSH, Ramiz Alia shprehu gatishmërinë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA dhe Bashkimin Sovjetik⁵⁵. Dy javë më pas Departamenti i Shtetit, do të deklaronte se “porta jonë është e hapur për rifillimin e marrëdhënieve diplomatike, dhe ne jemi gati të zhvillojmë diskutime për t’ia arritur këtij qëllimi”⁵⁶. Kontaktet e para shqiptaro-amerikane në bisedimet e zhvilluara në New York e Washington [në maj e gusht 1990] nuk dhanë rezultatet e pritshme nga qeveria shqiptare, ndonëse ajo fitoi statusin e vendit vëzhgues në KSBE dhe lejoi ushtrimin e lirive fetare e njerëzore në vend. Ngjarjet e ambasadave në korrik 1990 i “ngrinë” marrëdhëniet me vendet perëndimore. Tashmë SHBA do t’i kërkonin qeverisë shqiptare, që të pranonte të vendoste pluralizmin dhe demokracinë në vend. Vetëm pas plotësimit të këtij kushti, më 15 mars 1991, qeveria amerikane nënshkroi

⁵¹ *AMPJ*, V. 1986, D. 689, Relacion i Reiz Maliles për Komitetin Qendror të PPSH, më 02 tetor 1986.

⁵² M. Dornfeldt, E. Weewald, “Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike...”.

⁵³ P. Milo, “Politika e Jashtme e Shqipërisë ...”, f. 332.

⁵⁴ *AMPJ*, V. 1989, D. 793, fl. 2-3, 11.

⁵⁵ *Po aty*, V. 1989, D. 145, fl. 21.

⁵⁶ P. Milo, “Politika e Jashtme e Shqipërisë ...”, f. 332.

në Washington “Memorandumit e Mirëkuptimit” me qeverinë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

Politika e Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën do të ecte në shtigjet e interesave të veta, por edhe të aleatëve të saj perëndimorë. Ajo synonte të normalizonte marrëdhëniet me Shqipërinë dhe ta mbante atë larg sferës së influencës së BS. Arritja e këtij objekti, ndryshe nga SHBA [që e kishte derën të mbyllur] dukej e realizueshme. Por, arritja e tij e bënte të nevojshëm njëfarë korrigjimi të formulës britanike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të trashëguara. Rrethanat e reja që u krijuan pas prishjes së Shqipërisë me Kinën, ndikuan tek disa intelektualë britanikë e dashamirës të Shqipërisë, si Martin Moir⁵⁷, por edhe tek disa parlamentarë të këtij vendi, për t’i ofruar Shqipërisë mundësi dhe rrugë më të pranueshme për kapërcimin e mosmarrëveshjeve të vjetra dhe për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Në Dhomën e Komuneve pati zëra që fajësonin Jugosllavinë për Incidentin e Kanalit të Korfuzit, që pranonin se shërbimet e fshehta britanike e amerikane në vitet 1949-1953, kishin organizuar operacione për rrëzimin e qeverisë shqiptare etj. Ndonëse qeveria britanike e mohoi ekzistencën e këtyre operacioneve, ajo vazhdoi të hidhte disa hapa për afrim me Shqipërinë. Ministri i Shtetit, Peter Blaker, më 25 shkurt 1980 shprehu gatishmërinë e qeverisë së tij, për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, duke qenë i ndërgjegjshëm për pengesat që gjendeshin në këtë rrugë. Peter Blaker vinte në dukje se, qeveria shqiptare vazhdonte ta refuzonte vendimin e Gjykatës së Hagës për të dëmshpërblyer Anglinë, ndërsa theksonte se, kthimi i arit monetar nuk ishte vetëm një çështje që i përkiste Britanisë së Madhe, por edhe SHBA e Francës, si vende anëtare të Komisionit Tripalësh. Ministri britanik, për herë të parë që nga viti 1949, doli me një propozim të ri dhe të ndryshëm nga ai i mëparshmi. Ai hodhi idenë e ndarjes së çështjeve financiare, si kusht për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Më 19 maj 1980, Peter Blaker do të deklaronte se, “ne së fundi i propozuam qeverisë shqiptare që të vendosnim marrëdhëniet diplomatike, pa pritur të zgjidheshin problemet financiare..., për fat të keq shqiptarët nuk janë dakord me këtë”⁵⁸.

⁵⁷ AMPJ, V. 1980, D. 1158/2, fl. 28.

⁵⁸ Po aty, V. 1980, D. 1158/2, fl. 178, John Briggs për Martin Moir, 20 maj 1980.

Formula e re e anglezëve u refuzua nga qeveria shqiptare. Ajo vazhdoi t'i kërkonte qeverisë britanike, kthimin e arit dhe pastaj të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike. Përpjekjet e Martin Moir për të ndërmjetësuar midis të dyja qeverive nuk patën sukses. Qeveria shqiptare e quajti atë diplomaci paralele dhe të porealizueshme.

Pavarësisht nga interesi ekonomik dhe politik në rritje i të dy qeverive, marrëdhëniet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe mbetën në nivele të ulëta. Eksportet angleze në Shqipëri në vitin 1979 llogariteshin në rreth 700 000 £, ndërsa importet në rreth 62 000 £. Produktet angleze të eksportuara në Shqipëri përbëheshin nga pajisje e makineri industriale, telekomunikacioni, elektrike dhe mallra të manifakturuara, ndërsa mallrat shqiptare ishin në shumicën e tyre fruta dhe perime.

Me gjithë vështirësitë serioze ekonomike, politike e sociale që po kalonte Shqipëria dhe impulset në rritje të qeverisë britanike për t'u afruar me Shqipërinë, qeveria shqiptare u tregua e rezervuar dhe shumë e matur për t'u hapur me të dhe me Perëndimin. Në pamundësi për të realizuar kontakte direkte me Shqipërinë, si qeveria britanike ashtu edhe ajo amerikane nxitën Francën që të merrte përsipër rolin e ndërmjetësimit. Në prill 1984, ambasadori francez në Tiranë i paraqiti Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, "propozimin prej 7 pikash", i cili në thelb përmbante kushtet për zgjidhjen e problemit të arit monetar shqiptar. Zgjidhja e tij kushtëzohej me dhënien e një kompensimi prej 2 milion \$ për secilën nga dy qeveritë perëndimore. Qeveria shqiptare e priti mirë propozimin, por nuk qe dakord me disa pika të tij. Ajo kërkoi që së bashku me arin monetar, t'i ktheheshin edhe interesat e tij.

Me iniciativën e qeverisë britanike u propozua që të zhvilloheshin bisedime direkte në Paris. Britania e Madhe mori përsipër që t'i bënte të njohura qeverisë shqiptare edhe pretendimet financiare amerikane. Me gjithë fleksibilitetin e delegacionit britanik dhe dëshirën e mirë të delegacionit shqiptar, bisedimet e vitit 1985 (mars-korrik) përfunduan pa rezultat. Delegacioni shqiptar, siç dëshmon një nga anëtarët e tij, prof. Ksenofon Krisafi, "dështoi në mënyrë të suksesshme"⁵⁹. Ai nuk i pranoi kërkesat amerikane për dëmshpërblim dhe e kushtëzoi rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Britaninë e Madhe me kthimin prej saj të arit shqiptar së bashku me interesat.

⁵⁹ K. Krisafi, *Në kërkim të arit ...*, f. 254.

Negociatat shqiptaro-britanike do të vazhdonin në New York në vitin 1987 e 1988. Propozimi britanik në këtë raund bisedimesh përmbante një element të ri për kapërcimin e mosmarrëveshjeve: zgjidhjen e pretendimeve të anglo-amerikanëve, në të njëjtën kohë me zgjidhjen e problemit të arit shqiptar. Por, përfaqësuesit shqiptarë, të instruktuar nga udhëheqja e lartë e vendit, kërkuan sërish të mos përfshiheshin në bisedime pretendimet amerikane, që qeveria britanike të zhbllokonte arin, të paguante interesat e papaguara, të dëmshpërblente Shqipërinë për dëmet që i ishin shkaktuar vendit nga operacionet anglo-amerikane të viteve 1949-1953 dhe pastaj të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike. Ky qëndrim i riktheu raportet ndërmjet të dy vendeve në pikën e nisjes.

Në bisedimet shqiptaro-britanike, të zhvilluara në vitin 1990, në Romë e në Gjenevë, do të sheshoheshin mosmarrëveshjet kryesore, të cilat do t'i hapnin rrugë rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike më 29 maj 1991. Problemi i arit monetar shqiptar dhe i pretendimeve financiare britanike e amerikane me Shqipërinë do të kërkonte bisedime të tjera në të ardhmen. Përfundimisht, pretendimet e të dy palëve do të gjenin zgjidhje në vitet 1996-1998, kur më në fund pas një periudhe të gjatë mbi 50-vjeçare, Shqipërisë iu kthye edhe ari monetar.

S u m m a r y

EFFORTS TO GET CLOSE: THE RELATIONS OF ALBANIA WITH USA AND GREAT BRITAIN IN THE 70S AND 80S

The article above deals with the Albanian efforts to get close to USA and Great Britain in the 70s and 80s of the past century which were finalized in 1991 after the fall of the communist regime in Albania. The efforts to normalize the relations of Albania with Great Britain were impeded by the unsolved questions carried on since after World War II like the unpaid reparations of Albania for the Corfu Channel Incident and the blockade of Albanian monetary gold imposed by the Tripartite Commission behind which stood Great Britain. Despite the steps taken by both sides in the 80s, these two problems came to no solution and as a result no diplomatic relations were reestablished. The Albanian government proved rigid and respected old political schemes.

From the second half of the 60s and on the US was the initiator of the reestablishment of diplomatic relations with Albania, but the communist governments turned it down permanently. The fear of the communist leadership from the US and the Soviet Union was sanctioned even in the constitution of 1976 which forbade the reestablishment of diplomatic relations with these two countries.

The article brings forth new estimations and interpretations as well as the viewpoints of the governments of all three parties. The article is based on a rich documentary source basis referring to Albanian, American and British diplomatic archive documents.